



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 117/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.03.2019, shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE “Kevin Konstruktion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt, “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare, fshati Fshat”, me nr. REF-95454-11-22-2018, me fond limit 18,447,584 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: BOE “Kevin Konstruktion” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës
Adresa: Sheshi “Skënderbej“, lagjia nr.5, Kukës.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 23.11.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt, “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare, fshati Fshat”, me nr. REF-95454-11-22-2018, me fond limit 18,447,584 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

II.2 Në datën 26.12.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 10.01.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. “Kevin Konstruksion” & “Shendelli” shpk | 13,678,199.50 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Ouen” & “Shpresa AI” shpk | 17,155,882.00 lekë, Kualifikuar; |
| 3. “Sterkaj” shpk | 17,835,783.00 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “Alba Konstruksion” shpk | 18,022,811.00 lekë, Skualifikuar; |
| 5. “Lala” shpk | 18,445,747.00 lekë, Skualifikuar; |
| 6. “Elda-VI” shpk | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |

II.4. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“1.Çertifikata Nr.011391 “Deshmi e kualifikimi e sigurimit teknik” e leshuar per punonjesin Selami Ferizaj me profesion Hidraulik, sipas fotos eshte leshuar edhe per punonjesin Gentian Skermaj, me profesion murator, me çertifikate Nr.009431

2.Subjekti “Shendelli” sh.p.k per drejtuesin teknik ing. Vera Shehu, nuk ka dorezuar CV

3.Subjekti “Kevin Konstruksion” sh.p.k, nuk disponon tabelat paralajmeruese per sigurine ne objekt. Sipas Fatures Tatimore Nr.2, date 20.11.2015, materiali i specifikuar ne kete fature (tabele sinjalistike rrugore) nuk perputhet me kerkesen e percaktuar ne DST

4.BOE nuk disponon materialin “rrjete mbrojtese”. Sipas Fatures Tatimore Nr.190, date 29.12.2011 , materiali i specifikuar ne kete fature (rrjet plastike suvatimi) nuk perputhet me kerkesen e percaktuar ne DST

5.BOE nuk ka paraqitur Deshmi te Aftesise Profesionale) per drejtuesit e makinerive te renda te ndertimit ,sipas kerkeses se percaktuar ne piken 4/e te DST • Pas verifikimit te dokumentacionit si dhe liste-pagesave te BOE, rezulton se nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion per drejtuesit e makinerive te renda nga te dy shoqerite. • Për këta punonjës duhej të paraqitej kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e aftesise profesionale (të vlefshme), te lëshuara nga institucionet përkatëse si dhe të figuronin në list-pagesat e shoqërisë.

6. Subjekti nuk ploteson kriterin e numrit te mjeteve tip kamionçine per zbatimin e kontrates (2 cope) sipas kerkeses se percaktuar ne piken 7/a te DST

7. Mjeti tip – autovinç, me targe TR 7972 S, nuk ploteson kerkesat e percaktuara lidhur me kapacitetin ngrites (6 -10 ton)

8. BOE “Kevin Konstruksion & Shendelli” sh.p.k, nuk zotëron kapacitetin e mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve dhe pajisjeve për të realizuar kontratën për këtë procedure prokurimi.

9.Nga verifikimi i listes-pagesave te subjektit “Kevin Konstruksion” sh.p.k (Formulari E-SIG 025/a) rezulton se ne kete dokument nuk eshte perfshire stafi punonjes i kualifikuar i shoqerise, sipas kerkeses se percaktuar ne piken 2.3/3 te DST, dhe konkretisht: • Per periudhen janar-tetor 2018 subjekti nuk konfirmon faktin se pjese e struktures se tij eshte dhe stafi i punonjesve te kualifikuar ne profile te ndryshme si: Teknik Ndertimi, murator, elektrikist, hidraulik, murator, bojaxhi si dhe punonjes ndertimi

10.Nga verifikimi i listes-pagesave te subjektit “Shendelli” sh.p.k (Formulari E-SIG 025/a) rezulton se ne kete dokument nuk eshte perfshire stafi punonjes i kualifikuar i shoqerise, sipas kerkeses se percaktuar ne piken 2.3/3 te DST, dhe konkretisht: • Per periudhen janar-tetor 2018 subjekti nuk konfirmon faktin se pjese e struktures se tij eshte dhe stafi i punonjesve te kualifikuar ne profile te ndryshme si: Murator, elektrikist, hidraulik, murator, bojaxhi si dhe punonjes ndertimi”

II.5.Në datën 11.01.2019, BOE “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ngre pretendime mbi ofertën e paraqitur nga BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 166 Prot. datë 21.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimes “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k., duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 28.01.2019 BOE “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si më poshtë vijon:

“[...]Deshmia e kualifikimit nga Institucioni i TCPE per punonjesin S. F. ne profesionin Hidraulik dhe punonjesin G. S. ne profesionin Murator, eshte bere nje lapsus nga drejtuesit e ketij institucioni duke vendosur fotot e S. F. si Hidarulik dhe tek G. S. si Murator. Bashkangjitur po ju dergojme dhe shkresen nga Drejtuesi i Institucionit te TCPE. Ne nenin 53 “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 4, te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimet Publike” (i ndryshuar) theksohet: “Autoriteti kontraktor vlereson nje ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigojohen pa prekur përmbajtjen e saj. ” Nga sa me sipër, kemi te bëjme me nje devijim te vogel dhe per kete arsye autoriteti kontraktor duhet te vleresoje oferten tone si te vlefshme. Akoma me tej, autoriteti kontraktor nuk duhet te shmang faktin se shoqeria jone ka marre pjese si bashkim operatoresh ekonomik me operatorin ekonomik “Shendelliu”sh.p.k i cili e permbush kriterin per punonjes te certifikuar, nepermjet personave si ne vijim: A. K. (Murator); D. M. (Murator); F. R. (Murator); A. K. (Murator); F. A. (Murator); A. K. (Hidraulik) Shoqeria jone gjykon se me ane te kriterit te mesiperm, qellimi i autoritetit kontraktor eshte: vertetimi se operatoret ekonomike pjesemarres dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm (fuqinë punëtore) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, gjykojme se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shendelliu” sh.p.k ka vërtetuar se disponon punonjesit e certifikuar te kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Akoma me tej, ne daten 11.01.2019, shoqeria “Kevin Konstruktion”sh.p.k i eshte drejtuar shoqerise se Akreditimit te IQT-ve, “TCPE” sh.p.k, me ane te shkreses Nr.6Prot, date 11.01.2019, duke i kerkuar te na konfirmonin lapsusin e referuar me sipër. Ne daten 11.01.2019, shoqeria e Akreditimit te IQT-ve, “TCPE” sh.p.k, na vuri ne dispozicion Procesverbalet Nr.1, date 03.03.2018 dhe Nr.1, date 24.08.2018. Nga verifikimi i ketyre procesverbaleve, rezulton se kemi te bëjme me dy punonjes te ndryshem, ne dy profesione te ndryshme. (Bashkengjitur kesaj ankese gjenden dy procesverbalet).

Referuar Aktmarrveshjes Nr.5951Rep, Nr.1914Kol, date 25.12.2018, rezulton se zerat qe kane te bëjme me punimet elektrike jane marre persiper te realizohen nga anetari i bashkimit te operatoreve shoqeria “Kevin Konstruktion”sh.p.k., per rrjedhoje edhe paraqitja e Ing Elektrik bashke me CV jane paraqitur nga kjo shoqeri. Shoqeria jone gjykon se me ane te kriterit te mesiperm, qellimi i autoritetit kontraktor eshte vertetimi se operatoret ekonomike pjesemarres dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm (fuqinë punëtore) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, gjykojme se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruktion” sh.p.k ka vërtetuar se disponon Ing Elektrik bashke me CV te kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Rezulton se shoqeria “Kevin Konstruktion”sh.p.k ka marre pjese ne procedure e prokurimit si bashkim operatoresh ekonomik me operatorin ekonomik “Shendelliu” sh.p.k per te cilen kane paraqitur Aktmarrveshjes Nr.5951Rep, Nr.1914Kol, date 25.12.2018. Shoqeria jone gjykon se me ane te kriterit te mesiperm, qellimi i autoritetit kontraktor eshte vertetimi se operatoret ekonomike pjesemarres dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm (fuqinë punëtore), pajisjet në përputhje me kërkesat e autoritetit

kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, gjykojmë se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “shendelliu” sh.p.k ka vërtetuar se disponon Tabelat Sinjalistike per Kantjere te kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Per sa me sipër, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

Kujtojmë këtu se shoqëria jone nuk ka marrë pjesë si operator i vetëm por si bashkim operatorësh ekonomik me shoqëri “Shendelliu” sh.p.k. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në (SPE) nga ky operator, rezulton se është ngarkuar edhe Fatura me nr serie: 41228547, date 27.05.2003, Nr. Fature 39, për 1500 m² “rrjete” si dhe bashkëngjitur “Fatura të Ndryshme 3” gjenden Fotot që vërtetojnë këto pajisje. Për kriterin është përmbushur nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “Shendelliu” sh.p.k.. Gjithashtu, Rrejtja është shënuar si ze edhe në Shtojcën e Makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik “Shendelliu” sh.p.k.. Rezulton se shoqëria “Kevin Konstruktion” sh.p.k ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit si bashkim operatorësh ekonomik me shoqëri “Shendelliu” sh.p.k e vërtetuar kjo me anë të Aktmarrvëshjes Nr.5951Rep, Nr.1914Kol, date 25.12.2018, administruar në (SPE). Shoqëria jone gjykon se me anë të kriterit të mesipër, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm, pajisjet në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, gjykojmë se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shendelliu” sh.p.k ka vërtetuar se disponon Rrjeten mbrojtëse për Kantier të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Per sa me sipër, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

Bazuar në sa më sipër, shoqëria jone gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit, është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të disponojnë por jo që të paraqesin Dëshmi të aftësisë profesionale ose leje manovrimi për makineritë të renda. Edhe njëher referuar kriterit të vecantë të kualifikimit, rezulton se autoriteti ka specifikuar: “Për gjithë drejtuesit e makinerive të renda, sipas Urdhërit Nr. 44, datë 04.02.2004 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhenien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të renda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” duhet të jenë të pajisur me Dëshmi të aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme leshuar nga organet përkatëse.” Shoqëria jone rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriteret që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Referuar kriterëve të vecantë të kualifikimit, rezulton të jenë kërkuar: “2 kamioncina (2.5-7 ton) ” Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jone ka paraqitur: 1. Kamioncina 3.6 ton, me targa AA267PJ, marrë me qira nga shoqëria “Geci” Sh.p.k, me anë të Kontrates Nr.Rep:5953, Nr.Kol 1916, date 25.12.2018, me afat.. për të gjithë kohën e punimeve, nëse kompania shpallet fitues; 2. Kamioncina 2.5 ton, TR7972B, e shoqërisë “Kevin Konstruktion”; sh.p.k. 3. Shojcën e automjeteve të shoqërisë ngarkuar në (SPE) ku rezultojnë të përshkruara edhe mjetet e referuar mesipër. Nga

sa me siper, shoqeria jone eshte ne permbushje te kriterit kualifikues dhe skualifikimi eshte teresisht i paligjshem dhe tendecioze. Per sa me siper, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qendron.

Skualifikimi eshte bere teresisht ne menyre diskriminuese pasi kerkesa per Autovinc eshte permbushur nga shoqeria "Kevin Konstruksion" sh.p.k dhe konkretisht eshte Autovinci TR0482T shoqeruar me te gjitha dokumentacionin perkates si dhe pasqyruar ne Shtojcen e mjeteve te shoqerise. Per sa me siper, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qendron.

Kundershtojme arsyen e tete te skualifikimit qe ka te beje me "8-BOE" Kevin ConstmkSION-Shendelliu "shpk, nuk zoteron kapacitetin e mjaftueshem teknik persa i perket mjeteve dhe paisjeve per te realizuar kontraten per kete procedure prokurimi per arsye se: Bashkimi i operatoreve ekonomik ka permbushur kerkesat e kualifikimit sic edhe kemi argumentuar ne pikat me siper. Per sa me siper, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qendron.

Ne permbushje te kriterit, shoqeria "Kevin Konstruksion" sh.p.k, ka paraqitur dokumentacionin si ne vijim: 1. Vertetim shkarkuar nga E-Albania date 23.12.2018, per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore per periudhen Janar- Tetor 2018, per nje numer mesatar punonjesish prej 44; 2. Listpagesat per Janar 2018-Tetor 2018, ku rezulton se shoqeria disponon 44 punonjes mesatarisht ne muaj; Ndersa shoqeria "Shendelliu" sh.p.k, ka paraqitur dokumentacionin si ne vijim: 1. Vertetim shkarkuar nga E-Albania date 25.11.2018, per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore per periudhen Janar-Tetor 2018, per nje numer mesatar punonjesish prej 94; 2. Listpagesat per Janar 2018-Tetor 2018, ku rezulton se shoqeria disponon 94 punonjes mesatarisht ne muaj; Bazuar në sa më sipër, shoqeria jone gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit, nuk është kërkuar që ne listpagesa te figurojnë sipas emertimit te kualifikimit. Shoqeria jone rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdoren kriterë që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Per sa me siper, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qendron.

Kundershtojme kualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomik "Ouen" sh.p.k & "Shpresa AL " sh.p.k, per arsyet si ne vijim: Autoriteti kontraktor ne kriteret kualifikuese ne piken 2.3 Kapaciteti Teknik pikat 3 dhe 4 ka kerkuar: 3. Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve te jete mesatarisht jo me pak se 50 (pesedhete) punonjës. Numri i punonjesve te jete mesatarisht jo me pak se 50 (pesedhete) punonjës te siguruar per periudhen Janar 2018 - Tetor 2018 dhe brenda kesaj strukture te jete e perfshire dhe stafi drejtues. Kjo te deshmohe me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (Formulari E-SIG 02/a) dhe te shoqerohet me formularet E-SIG 025/a. Operoret ekonomik duhet te dorezojne List-Pagesat e punonjesve per periudhen e mesiperme, në të cilat duhet të jetë i përfshirë përveç punonjesve edhe stafi i drejtuesve teknik. Operoret Ekonomik per përmbushjen me sukses të kontratës, duhet te vërtetojnë se zotërojnë nje staf teknik, te pajisur me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale për ekzekutimin e objektit të prokurimit:

Nr.	Profesioni (stafi teknik)	Nr. i Punonjesve
1.	Inxhinier Ndertimi	1 (nje)
2.	Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
3.	Inxhinier Elektrik	1 (nje)
4.	Inxhinier Topograf	1 (nje)
5.	Inxhinier Mjedisi	1 (nje)

Ne permbushje të këtij kriteti bashkimi i operatoreve ekonomik kane paraqitur kontrate pune per Inxhinier Hidroteknik znj.E. P.. Kjo inxhiniere është e deklaruar në listëpagesat e Janar 2018 me 15 dite pune, e keshtu me radhe per te gjithë muajt pasardhes deri ne Nentor 2018 , cka bie në kundërshtim me ligjin ku është specifikuar se inxhinierat drejtues teknik të shoqërive të zbatimit duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë, në baze te VKM nr 943 dt 28.12.2016. Gjithashtu për këtë punonjës është paraqitur kontrata e punës me nivel page 40,000 ndërsa në listëpagesa është i deklaruar me 23.077 lekë cka përbënë evazion fiskal dhe shkelje ndaj përmbushjes së detyrimeve në tatime të shoqërisë. Gje qe nuk ofron besueshmeri per te kryer me sukses punen qe ato kane dal fitues. Ne permbushje të këtij kriteti bashkimi i operatoreve ekonomik kane paraqitur kontrate pune per Inxhinier Mjedisi z.Bledar Methhoxha. Ky inxhiniere është e deklaruar në listëpagesat e Janar 2018 me 15 dite pune, e keshtu me radhe per te gjithë muajt pasardhes deri ne Nentor 2018 , cka bie në kundërshtim me ligjin ku është specifikuar se inxhinierat drejtues teknik të shoqërive të zbatimit duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë, ne baze te VKM nr 943 dt 28.12.2016. Gjithashtu për këtë punonjës është paraqitur kontrata e punës me nivel page 40,000 ndërsa në listëpagesa është i deklaruar me 23.077 lekë cka përbënë evazion fiskal dhe shkelje ndaj përmbushjes së detyrimeve në tatime të shoqërisë. Gje qe nuk ofron besheshmeri per te kryer me sukses punen qe ato kane dal fitues. Ne permbushje të këtij kriteti bashkimi i operatoreve ekonomik kane paraqitur kontrate pune per Inxhinier Elektrik Z.D. K.. Ky inxhiniere është e deklaruar në listëpagesat e Janar 2018 me 12 dite pune, e keshtu me radhe per te gjithë muajt pasardhes deri ne Nentor 2018 , cka bie në kundërshtim me ligjin ku është specifikuar se inxhinierat drejtues teknik të shoqërive të zbatimit duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë, ne baze te VKM nr 943 dt 28.12.2016. Gjithashtu për këtë punonjës është paraqitur kontrata e punës me nivel page 40,000 ndërsa në listëpagesa është i deklaruar me 23.077 lekë cka përbënë evazion fiskal dhe shkelje ndaj përmbushjes së detyrimeve në tatime të shoqërisë. Gje qe nuk ofron besueshmeri per te kryer me sukses punen qe ato kane dal fitues. Ne permbushje të këtij kriteti bashkimi i operatoreve ekonomik kane paraqitur kontrate pune per Inxhinier Topograf Xh. Z.. Ky inxhiniere është e deklaruar në listëpagesat e Janar 2018 me 12 dite pune, e keshtu me radhe per te gjithë muajt pasardhes deri ne Nentor 2018 , cka bie në kundërshtim me ligjin ku është specifikuar se inxhinierat drejtues teknik të shoqërive të zbatimit duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë, ne baze te VKM nr 943 dt 28.12.2016. Gjithashtu për këtë punonjës është paraqitur kontrata e punës me nivel page 40,000 ndërsa në listëpagesa është i deklaruar me 23.077 lekë cka përbënë evazion fiskal dhe shkelje ndaj përmbushjes së detyrimeve në tatime të shoqërisë. Gje qe nuk ofron besueshmeri per te kryer me sukses punen qe ato kane dal fitues.[...]"

II.8.Në datën 11.02.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.404prot., datë 08.02.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]6. Subjekti nuk ploteson kriterin e numrit të mjeteve tip kamionçine për zbatimin e kontratës (2 cope) sipas kërkesës së percaktuar në pikën 7/a të DST [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 12, pika 2.3.7.a, “Për kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“7.Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (Shtojca 10).

a).Në funksion të zbatimit të kontratës, kërkohej të jenë në dispozicion këto mjete/makinë pune:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Kamiona vetëshkarkues (kapaciteti total mbajtes minimumi 8 ton)	Cope	3	Pronësi ose me qera
2.	Kamionçine (kapaciteti total mbajtes 2.5 - 7 ton)	Cope	2	Pronësi ose me qera
2.	Fadrome me goma	Cope	1	Pronësi ose me qera
3.	Auto vinç me kapacitet ngrites 6 - 10 ton	Cope	1	Pronësi ose me qera
4.	Vinç karele	Cope	1	Pronësi ose me qera
5.	Matrapik	Cope	3	Pronësi ose me qera
6.	Motogjenerator	Cope	1	Pronësi ose me qera
7.	Betoniere	Cope	6	Pronësi ose me qera
8.	Skele ndertimi metalike	m2	500	Pronësi ose me qera
9.	Rrjete mbrojtese	m2	500	Pronësi ose me qera
10.	Vibrator betoni	Cope	1	Pronësi ose me qera
11.	Pompe suvatimi	Cope	3	Pronësi ose me qera

III.1.2. Operatorët ekonomikë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k., kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para një noteri Nr.5951Rep., Nr.1914Kol. Referuar kontratës së bashkëpunimit të mësipërme parashikohet se “[...]palët kanë rënë dakort që detyrat për realizimin e objektit të mësipërm si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë: Shoqëria “Kevin Konstruksion” sh.p.k., në masën 69.10%. Shoqëria “Shendelli” sh.p.k., në masën 30.90%.

Elementët konkret që do të kryej sejcili prej operatorëve ekonomik janë të ndara për cdo zë pune sipas preventivit të dorëzuar në këtë procedurë prokurimi. Secili operator do të kryej përgjindjen e caktuar të marrë përsipër për sejcilin nga zërat e punës të specifikuar në preventivin e ndarjes së punimeve bashkëlidhur kësaj aktmarrëveshje[...]”

III.1.3.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti

kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.4.Neni 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.5. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.6.Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k., pjesëtarë i BOE ankimues, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë qiraje nr.5953Rep., nr.1916Kol., datë 25.12.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Geci” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhenien me qira të automjetit “kamioncinë” me targë AA267PJ., shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Dokumentacioni përkatës për mjetin në pronësi të shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k., me targë TR7972S.
3. Dokumentacioni përkatës për mjetin në pronësi të shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k., me targë TR0482T.
4. Shtojcën nr. 10 mbi disponimin e makinerive.

III.1.7.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, përkatësisht shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, me anë të së cilës pjesëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k.,

deklaron se zotëron mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kamioncinat, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i tij, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si më poshtë:

1. Kamionçinë (kapaciteti total mbajtës 2.5-7 ton):

- Për mjetin me targë TR7972S, kapaciteti mbajtës = 2.42 ton (më pak se 2.5 ton).

- Për mjetin me targë AA267PJ, kapaciteti mbajtës = 3.69 ton, (në përputhje me DST).

2. Kamiona vetëshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 8 ton):

- Për mjetin me targë TR0482T, kapaciteti mbajtës = 8.4 ton (në përputhje me DST).

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me disponueshmërinë e mjeteve Kamioncina, konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruksion” sh.p.k., referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të përmbushë 69.10% të kontratës objekt prokurimi, përkatësisht, të gjitha zërat e preventivit për të cilat nevojiten mjetet kamioncina vetëshkarkuese, për këtë arsye, operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k., referuar zërave të preventivit të marrë përsipër për të kryer, duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se disponon 2 (dy) Kamionçina (kapaciteti total mbajtës 2.5-7 ton). Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e mjeteve sipas kapacitetve dhe në numrin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet tonazhi i kërkuar i mjeteve, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Kevin Konstruksion” sh.p.k. është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 12, pika 2.3.7.a, “Për kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, sipas kontratës së bashkëpunimit, në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: *”Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.9. Në rast se BOE ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi BOE nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Kevin Konstruksion” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt, “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare, fshati Fshat”, me nr. REF-95454-11-22-2018, me fond limit 18,447,584 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 130 protokoli Datë 28.01.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha